

VENDIM
Nr. 518, datë 21.12.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
BERAT-KUÇOVË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM-ja nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 21.12.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Ujësjellës-Kanalizime Berat-Kuçovë, me shkresën nr. 1524 prot., datë 10.12.2021, ka paraqitur kërkesën pranë ERRU-së për rinovim licence të shoqërisë, për kategorinë A të shërbimit - grumbullimi dhe shpërndarja e ujit për konsum publik, dhe kategorinë C të shërbimit - largimi i ujërave të ndotura, për efekt të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR-ja) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Berat-Kuçovë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM-ja nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) Shoqëria UK Berat-Kuçovë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 132 163 banorë të Bashkisë Berat-Kuçovë;

b) Drejtuesja teknik, znj. Aleksandra Kllapi, është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Hidroteknike, në vitin 1986 dhe ka mbi 5 vite përvojë në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Berat-Kuçovë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësitë tekniko-profesionale, aftësitë financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve, të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Berat–Kuçovë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. me (NUIS J62903166T), në kategoritë:

- a) Kategoria A – Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategoria C – Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues ligjor – Pelivan Sinaj;
- b) Drejtuese teknike – Aleksandra Kllapi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. është Bashkia Berat–Kuçovë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës, brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani